

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

në mes të

UNI-Universum International College

dhe

Qendra "RI-JETA" - Ferizaj

I. Qëllimi i Memorandumit

II. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim

III. Fushëveprimtaria

Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët pajtohen të bashkëpunojnë në realizimin e aktiviteteve, fushatave, me interes të përbashkët.

1. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, UNI dhe "RI-jeta" do t'u mundësojnë studentëve të Programit Psikologji ne kryerjen e praktikës në këtë qendër.
2. Realizimin e projekteve të përbashkëta në segmente që mund të identifikohen në proces gjatë bashkëpunimit tonë.

III. Përdorimi i Informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;


2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellë me besueshmëri të plotë;

3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.
4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi nuk është e kufizuar.
5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.


Ferizaj, më: 31.05.2024

PALËT NËNSHKRUESE

Universum International College



Qendra "Ri-Jeta"-Ferizaj



Arjeta Mustiu
Drejtoreshë

